



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve*

31.01.2022

Prishtinë

I nderuar z. Fejzullahu,

Në vijim ju lutem gjeni komentet dhe propozimet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në lidhje me raportet e publikuara për konsultim publik:

- Raporti Konsultativ për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave Maksimale të Lejuara
- Raporti Konsultativ për Strukturën Tarifore

Shpresojmë që komentet dhe propozimet tona të ndikojnë pozitivisht në një raport përfundimtar që është i drejtë për të gjitha palët.

### **1. Komentet për Raportin Konsultativ për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave Maksimale të Lejuara**

Në raport, ZRRE propozon Të Hyra Maksimale të Lejuara prej 446.67 milionë euro, të cilat me tarifat aktuale sipas ZRRE-së projektohet se do të mbulohen me 314.34 milionë euro. Kjo ka rezultuar me një hendek prej 132.33 milionë euro, të cilat duhet të mbulohen qoftë me të hyra që mund të gjenerohen nga tarifa të reja, apo nga subvencionimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Nga totali prej 446.67 milionë euro, përshtatje nga viti 2021 janë 43.56 milionë euro, të hyra të lejuara për KEDS janë 174.5 milionë euro, dhe të hyra të lejuara për KOSTT janë 35.61 milionë euro.

Komentet tona dhe propozimet në lidhje me këtë raport, janë si në vijim:

### **1.1. Të mirret parasysh sjellja e konsumatorëve në raport me konsumin pas aplikimit të tarifave të reja**

Në raportin e paraqitur nuk duket se është marrë parasysh ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve karshi tarifave të ndryshuara. Shtimi eventual i një blloku të ri tarifor paevitueshëm do të rezultojë në racionalizim të konsumit, mirëpo në mungesë të një analize të ndjeshmërisë (sensitivity analysis), kjo gjë fare nuk është reflektuar në raportin konsultativ.

Për më tepër, ne si Qeveri jemi duke dizajnuar edhe masa nxitëse për ato amvisëri që zvogëlojnë konsumin në raport me vitin paraprak, për muajt e ftohtë kur konsumi është dukshëm më i lartë gjë që besojmë se do të rrisë edhe më tutje vullnetin për kursim të energjisë elektrike.

Nëse pas shtimit të bllokut të ri tarifor, dhe pas subvencionimit me masa nxitëse për reduktim të konsumit, supozohet se konsumi për muaj shkurt, mars, prill, nëntor dhe dhjetor<sup>1</sup> ulet për 5%, apo mesatarisht nga 16.5 GWh më pak import për secilin prej këtyre muajve, atëherë kjo rezulton me 18.69 milionë euro kosto më të ulët nga importi për të mbuluar humbjet, që do të duhej të reflektohej tek të hyrat e lejuara për mbulimin e humbjeve në rrjet.

Krahas kësaj, ulja e konsumit do të kishte ndikim edhe në të hyrat e mbledhura nga tarifatat, e që për këta muaj do të rezultonte me 4.25 milionë euro më pak të hyra sipas tarifave aktuale.

**Ndikimi i këtij propozimi: zvogëlim i të hyrave të lejuara për 18.69 milionë euro, dhe zvogëlim i të hyrave të mbledhura me tarifatat aktuale për 4.25 milionë euro.**

### **1.2. Heqja e konsumit të pjesës veriore të vendit nga përlllogaritja e humbjeve të lejuara për OSSH**

Në raport me furnizimin e pjesës veriore të vendit, ky obligim që nga viti 2017 nga ana e ZRRE-së i është imponuar KOSTT-it. Po ashtu që nga viti 2017 me aktgjykim të formës së prerë është ndaluar që shpenzimet për pjesën veriore të vendit të përfshihen në të hyrat e lejuara të OSSH (KEDS), apo në tarifatat e konsumatorëve.

Marrë parasysh këtë, është e pakuptimtë dhe e paligjshme që, në bazën për përlllogaritjen e humbjeve të lejuara në rrjet për OSSH (KEDS), të përfshihet edhe konsumi i pjesës veriore, kur dihet që OSSH (KEDS) nuk e furnizon pjesën veriore, e as nuk lejohet të mblidhen të hyra për këtë gjë sipas aktgjykimit të formës së prerë.

Nëse hiqet sasia e furnizuar për pjesë veriore prej 367 GWh nga baza e përlllogaritjes së humbjeve të lejuara, atëherë kjo rezulton me 66 GWh më pak tek niveli i humbjeve të lejuara, që përkthyer në vlerë, i bie 7.16 milionë euro më pak.

Nëse ky gabim është bërë edhe në vitet paraprake, atëherë ZRRE duhet të përkujdeset që këto mjete t'u kthehen konsumatorëve përmes pështatjes së të hyrave për vitin aktual.

**Ndikimi i këtij propozimi: zvogëlim i të hyrave të lejuara/hendekut për 7.16 milionë euro, shtu këtu edhe përshtatjen për korrëgjim për vitet e kaluara, përafërsisht 2-3 milionë euro/vit që nga 2017.**

---

<sup>1</sup> Muajt kur numri i familjeve që preken nga blloku tarifor është më i lartë, dhe kur konsumi nuk arrin të mbulohej nga prodhimi vendor, që nënkupton se pjesa e humbjeve në rrjet që janë të lejuara, kryesisht importohet nga jashtë.

### 1.3. Kontigjencë – Aktgjykimi 1373/2017

Sipas Aktgjykimit 1373/2017, ZRRE obligohet që të ndërmarrë veprimet e nevojshme që e obligojnë OSSH (KEDS) që të bëjë kthimin apo kompensimin e shumës së faturuar konsumatorëve prej 40,855,480 euro, në emër të mbulimit të furnizimit të pjesës veriore.

Ky aktgjykim është apeluar tashmë nga ana e ZRRE, dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë.

Megjithatë, do të ishte më se e drejtë, që nën dritën e shpërndarjes sa më të drejtë të barrës në krizën aktuale, kjo shumë të njihet si kontigjencë në kuadër të të hyrave maksimale të lejuara të OSSH, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Nëse vendimi përfundimtar rezulton në konfirmim të aktgjykimit të gjykatës themelore, atëherë obligimi do të konsiderohej i përbushur, në të kundërtën, këto të hyra do të njiheshin si përshtatje në vitin vijues.

Ndikimi i këtij propozimi: **zvogëlim i të hyrave të lejuara/hendekut për 40.86 milionë euro.**

Nëse propozimet e MFPT do të merreshin parasysh, rezultati për të hyrat e lejuara dhe për hendekun që duhet mbuluar do të ishin si në tabelën në vijim:

Tabela 1:

(milionë EUR)	MAR	Të hyrat me tarifat aktuale	Hendeku
Propozimi i ZRRE	446.67	314.33	132.34
Propozimi i MFPT (pa kontigjencë)	420.82	310.08	110.74
Propozimi i MFPT (me kontigjencë)	376.96	310.08	66.88

## 2. Komentet për Raportin Konsultativ për Strukturën Tarifore

Propozimi i ZRRE ka paraparë që ndryshimi i strukturës tarifore të bëhet vetëm për amvisëritë, duke anashkaluar bizneset, gjë që e konsiderojmë shpërndarje të padrejtë të barrës. Për më tepër, blloku i ri tarifor i propozuar fillon në konsumin mbi 600kWh mujor, gjë që e konsiderojmë tepër të ulët, sidomos kur merret parasysh fakti që ky ndryshim po propozohet të bëhet brenda një afati kaq të shkurtë.

Propozimet tona në lidhje me strukturën tarifore janë si në vijim:

### 2.1. Të ngritet pragu i bllokut të parë në 1,000 kWh, 500 kWh për TL dhe 500 kWh për TU

Për t'u siguruar se struktura e re tarifore për amvisëritë nuk rezulton në kosto të papërbalueshme për shumicën e familjeve, propozojmë që tarifën e bllokut të dytë të fillojnë tek pasi të jenë konsumuar 1,000 kWh, konkretisht 500 kWh me tarifën e lartë dhe 500 kWh me tarifën e lirë.

Së pari, ngritja e pragut nga 600 kWh në 1,000 kWh na siguron se që shumica e familjeve të mos preken nga rritja, dhe edhe ato që preken të mos përfundojnë me kosto të papërbalueshme. Në të njëjtën kohë, shtimi i bllokut të ri tarifor, edhe pas pragut prej 1,000 kWh do të rezultojë me racionalizim të konsumit në një rën të anë, dhe me rritje të të hyrave në anën tjetër.

Së dyti, kursimi mund të ndodh në dy mënyra: duke zvogëluar konsumin, dhe duke zhvendosur konsumin gjatë natës kur tarifa është e lirë. Prandaj e shohim si të domosdoshme që, në mënyrë që blloku i ri tarifor të rezultojë me përmbushjen e këtyre dy qëllimeve, të fiksohet asisoj që pragu prej 1,000 kWh të ndahet në 500 + 500, në vend të propozimit të ZRRE që kompozimi i bllokut të parë (TL vs TU) të bëhet sipas proporcionit të tërësisë së konsumit që ka pasur konsumatori gjatë muajit. Me fjalë tjera, tarifa aktuale prej 6.75 centë të vlejë për 500 kWh e para të shpenzuara gjatë ditës ndërsa për çdo kWh mbi këtë prag të konsumuar gjatë ditës të aplikohet tarifa e re. E njëjta do të vlente edhe për konsumin gjatë natës, ku 500 kWh e para do të tarifoheshin me 2.89 centë, dhe tarifën e reja do të aplikoheshin vetëm pasi të jetë tejkaluar ky prag.

Gjithashtu, propozojmë që ZRRE të shqyrtojë mundësinë e zbritjes së tarifave për bllokun e dytë, së paku që tarifa e lartë nga 14 centë të zbritet në 11.5 centë, ashtu që edhe kapërcimi nga njëra tarifë në tjetrën të jetë i përballueshëm.

Me këto propozime, do të gjeneroheshin 22.5 milionë euro shtesë nga amvisëritë, në krahasim me tarifën aktuale që mbledhen nga kjo kategori.

**Ndikimi i propozimit: shtim i tarifave të mbledhura (zvogëlim i hendekut) për 22.5 milionë euro.**

## **2.2. Barra të shpërndahej edhe tek bizneset**

Nga diskutimet që u zhvilluan në seancën parlamentare me temë pikërisht raportet konsultative të shqyrtimit të jashtëzakonshëm, kishte konsensus pothuajse nga të gjitha grupet parlamentare që barra të shpërndahej sa më barabartë, përfshirë edhe tek bizneset.

Në këtë frymë, nëse do të aplikohet barra e njëjtë sikurse për amvisëritë, proporcionalisht me tarifën ekzistuese, atëherë do të duhej që me tarifën e reja për bizneset të gjeneroheshin edhe rreth 17 milionë euro shtesë, mbi tarifën aktuale. Tarifën e reja do të duhej të zvogëlojnë dallimet në mes të kategorive të bizneseve, të cilat aktualisht janë tejet të mëdha nëse krahasojmë ta zëmë tarifën për 0.4kV Kategorinë 1 (bizneset e vogla me 10.71 centë/kWh) dhe Kategorinë 2 (supermarketet me 6.69 centë/kWh), ku dallimi shkon deri në 60%.

Për më tepër, një ripërshtatje më e drejtë, dhe një reflektim më i saktë i kostove në tarifën e bizneseve do të ndihmonte edhe në zbutjen e efektit të liberalizimit të tregut për këto kategori, kurdo që kjo ndodh në të ardhmen.

**Ndikimi i propozimit: shtim i tarifave të mbledhura (zvogëlim i hendekut) për 17 milionë euro.**

Si përfundim, nëse krahas propozimeve për MAR, merren parasysh edhe propozimet për sa i përket strukturës tarifore, do të kishim rezultatin si vijon:

Tabela 2:

(milionë EUR)	MAR	Të hyrat me tarifat aktuale	Hendeku	Propozimet 2.1 dhe 2.2	Nevoja për subvencionim nga Qeveria
Propozimi i MFPT (pa kontigjencë)	420.82	310.08	110.74	39.5	71.24
Propozimi i MFPT (me kontigjencë)	376.96	310.08	66.88	39.5	27.38

Në të dyja rastet e mësipërme, subvencionimi i zotuar i Qeverisë prej 75 milionë euro do të mjaftonte për të mbuluar hendekun e mbetur pas përshtatjeve sipas propozimeve që kemi paraqitur.

Mirëpresim çfarëdo kërkesë për konsultime apo informata shtesë në raport me propozimet tona.

Me t'mira,



Hekuran Murati